



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Doretuar Primijsena/Prodato Received/Delivery | 06.11.2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKMSTHUK | 6885/2023 | | 1/6 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1146/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi -Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1146/2023 të datës 06.09.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit numër të protokollit 1260/2023 të datës 15.08.2023 të Kryesueses së Komisionit Rekrutues në DMZP, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1146/2023 të datës 06.09.2023 të parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.Prot: 1260 i datës 15.08.2023 i Kryesueses së Komisionit të Pranimit, Njoftimi mbi rezultatet përfundimtare i datës 27.07.2023 i nxjerre nga Komisioni Vlerësues në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publik për procedurën e pranimit të shpallur sipas Konkursit me Nr. Reference: RN00011534 të datës 26.04.2023 për grupin "Specialist i Përgjithshëm për Inspektim", për pozitën e punës „Inspektor i Punës”, si dhe faza e vlerësimit përfshirë jetëshkrimin dhe intervistën me gojë lidhur me konkursin për pranim me numër reference RN00011534 të datës 26.04.2023 të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Komisioni i Pranimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publik i caktuar për këtë procedurë pranimi, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu që procedura e rekrutimit me numër referencë RN00011534 e datës 26.04.2023 *ktelhet në rishqyrtim nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve* tek Komisioni i Pranimit *gjegjësisht procedura të vazhdoj nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit* në pajtim me pikëpamjet juridike sipas këtij vendimi dhe dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komisioni Kombëtar për Klasifikim pas pranimit të kërkesave urgjente nga Inspektoratet e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, Inspektoratet e Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Shëndetësisë, me datë 18.04.2023 ka parashtruar propozimin për formimin e grupeve për klasifikim të vendeve të punës tek Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa ky i fundit përmes vendimit me Nr.1001/2023 të datës 19.04.2023 ka aprovuar kërkesën e verifikuar edhe nga Komisioni Kombëtar për Klasifikim për krijimin e grupeve ad hoc për pozitën e punës Specialist i Përgjithshëm për Inspektim.

Ministria e Punëve të Brendshme/ DMZP-ja me datën 26.04.2023 ka shpallur konkursin për Grupin „Specialist i Përgjithshëm për Inspektim“, për pozitën e punës „Inspektor i Punës“ në Inspektoratin e Punës në rajonin e Mitrovicës i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 17.05.2023 deri me datën 27.05.2023. Sipas listës së publikuar në Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ankuesi ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, sipas njoftimit të datës 20.07.2023 ankuesi është njoftuar lidhur me piket e testit me shkrim ku i njëjti ka arritur gjithsejtë 49 (dyzet e nëntë) pikë, ndërsa sipas njoftimit të datës 21.07.2023 ankuesi është njoftuar se në vlerësimin e CV është vlerësuar me 10.2 pikë, andaj ankuesi nuk ka arritur të kalojë në fazën e intervistës me gojë.

Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB me datë 27.07.2023 të ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues.

Ankuesi pas publikimit të njoftimit të datës 27.07.2023 për kandidatin e përzgjedhur, me datës 28.07.2023 ka parashtruar ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme –DMZP, ndërsa kjo e fundit me datën 15.08.2023 përmes vendimit me numër 1260/2023 i ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, mbi bazën e asaj që ankesa e parashtruar nga ana e ankuesit është e jashtëafatshme.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër protokolli 1260 të datës 15.08.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datën 06.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimor se Komisioni i Vlerësimit gjatë trajtimit të ankesës së datës 28.07.2023 nuk ka bërë rivlerësimin e drejtë të biografisë dhe përvojës, gjatë procesit të rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.09.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të ndërsa Këshilli më datë 10.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të

gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës; Vendimin me NR.1260/2023 të datës 15.08.2023; Ankesën e datës 28.07.2023 të parashtruar nga ankuesi tek organi I punësimit; Njoftimin e datës 20.07.2023; Njoftimin e datës 21.07.2023; Njoftimin e datës 27.07.2023 për kandidatin e suksesshëm; Njoftimin e datës 27.06.2023 për listën e ngushtë; Referencën e datës 24.11.2021; Vendimin mbi emërimin drejtorit të drejtorisë së inspektoratit komunal të datës 02.04.2019; Reference e datës 11.09.2017; Vërtetimin e datës 11.09.2017; Diplomën e datës 19.12.2015; Vërtetimin e kopjes me nr. LRP. Nr. rend.2244/2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.09.2023; Përgjigjenin në ankesë të datës 10.10.2023; Konkursin e datës 26.04.2023; Listën e aplikantëve me numër reference RN00011534; Vendimin me Nr.08/151 të datës 12.07.2023; Renditja përfundimtare e kandidateve (pa datë dhe numër); Njoftimin e datës 27.07.2023; aplikacionin e ankuesit të datës 19.05.2023; Diplomën e datës 19.12.2015; Referencën e datës 11.09.2017; Vërtetimin e datës 11.09.2017; Vendimin mbi emërimin e drejtorit të drejtorisë së inspektoratit komunal të datës 02.04.2019; Referencën e datës 24.11.2021; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 18.05.2023; Pasqyrën e llogarisë Trusti për periudhën kohore 01.08.2022 deri me datën 15.05.2023; Aplikacionin e datës 19.05.2023 të kandidatit Diplomën e datës 21.09.2007; Diplomën me numër 2181 datës 10.10.2019 me të cilin kandidati merr titullin Master i shkencave juridike; Certifikatën e datës 19.08.2019; Shkresën (pa date dhe numër); Kontratën e punës (pa date dhe numër); Pasqyrën e llogarisë Trustin për periudhën kohore 05.5.2016 deri me datën 15.05.2023; Certifikatën shëndetësore me numër CM0201 të datës 04.05.2023; Certifikatën mbi dënimet penale; Referencën e datës 06.01.2021; Referencën e datës 27.05.2021; Mirënjohjen e lëshuar nga kompania Shell Licence për vitin 2021; Aplikacionin e datës 19.05.2023 të kandidatit Diplomën me numër 3287 të datës 27.12.2013; Certifikatën e datës 21.12.20056; Certifikatën e datës 19.12.2005; Certifikatën e datës 2005; Vërtetimin mbi përvojën e punës të datës 22.11.2021; Vërtetimin mbi përvojën e punës të lëshuar nga CEDE; Certifikatën e datës 21.12.2005; Certifikatën e datës 19.12.2005; Dokumentin e identifikimit; Trusti për periudhën kohore 01.08.2002 deri me datën 16.05.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 16.05.2023; Aplikacionin e kandidatit të datës 24.05.2023; Diplomën me numër 29/16 të datës 26.05.2016; Diplomën me numër 3484 të datës 16.07.2013; Diplomën e datës 16.04.2004; Certifikatën e datës 28.02.2020; Certifikatën e datës 13.11.2012; Certifikatën e datës 06.11.2012; Certifikatën e datës 03.02.2014; Certifikatën e datës pa date dhe numër të lëshuar nga AUK; Certifikatën e datës 12.05.2010; Certifikatën (pa date dhe numër) të lëshuar Profil Grup; Certifikatën e datës 24.10.2007; Referencën pa datë dhe numër të lëshuar nga IPKO; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Pasqyrën e llogarisë Trustin për periudhën kohore 01.07.2009 deri me datën 22.05.2023; Aplikacionin e datës 19.05.2023 të kandidatit Diplomën me numër 182 të datës 06.05.2019; Diplomën me numër 459 të datës 30.05.2003; Diplomën për kryerjen e shkollës së mesme; Certifikatën e datës 17.09.2005; Certifikatën e datës 19.01.2007; Certifikatën e lëshuar nga Evropën Union Rule of Law Mission in Kosovë; Certifikatën e lëshuar lidhur me përfundimin me sukses të kursit në temën "Sundimi I Ligji"; Certifikatën e datës 20.08.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit Sundimi I Ligjit; Certifikatën e datës 13.06.2005; Certifikatën e datës 24.05.2018; Certifikatën e datës 08.06.2018; Certifikatën e datës 18.02.2015; Certifikatën e lidhur me përfundimin pes editor në projektin "Cycle Management and Basic Financial Management"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit për periudhën 12,13,14, dhe 15 Mars 2012; Certifikatën e datës 7, 8.04.2003; Certifikatën e lëshuar

nga Oda e Avokateve të Kosovës lidhur me përfundimin me suksese të praktikës dhe ndjekjen e të gjitha seminareve dhe trajnimeve të organizuara në vit 2002-2003 në kuadër të Projektit për Praktikant ; Certifikatën e datës 27.11.2001 lidhur me pjesëmarrjen e programit praktik juridik të Administratës Publike; Certifikatën e datës 26.04.2000; Certifikatën e lëshuar nga UNMIK; Certifikatën (pa datë dhe numër); Vërtetimin me numër të protokollit 4116/2022 të datës 14.09.2022; Vërtetimin me numër 4116/2022 të datës 14.09.2022; Vërtetimin me numër 522/09 të datës 17.07.2009; Letër rekomandimin me numër Ref. 4178 të datës 01.09.2002; Vërtetimin me numër 165/09 të datës 26.08.2009; Certifikatën e datës 04.07.2008; Vërtetimin lidhur me përvojën e kandidatit Letër of Employment Attestation të datës 03.03.2021; Letër rekomandimin e datës 01.08.2018; Letër rekomandimin e datës 16.11.2005; Dokumentin e identifikimit; Pasqyrën e Llogarisë Trusti të datës 17.03.2008 deri me datën 13.04.2022; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 08.02.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin e duhur tek diploma dhe përvoja e punës, pasi që të kriteri i përvojës i njëjti ka përvojë pune në fushë të inspektimit mbi dy vite, ndërsa kundër kandidatet, nuk kanë përvoja pune në fushën e inspektionit andaj me është bërë e pa drejtë gjatë vlerësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Konkursin me Nr. Reference: RN00011534, të datës 26.04.2023 për grupin „Specialist i Përgjithshëm për Inspektim“ në Inspektoratin e Punës, në rajonin e Mitrovicës, , si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fakultetin Juridik, Ekonomik, Shkenca Politike dhe Administratë Publike, Shkenca Sociale, dhe Edukim.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku dy vite përvoja pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për Plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesi dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik, ka kaluar fazën e verifikimit paraprak mirëpo përmes njoftimit të datës 20.07.2023 ankuesi në testin me shkrim ka arrit gjithsejtë 49 pikë ndërsa përmes njoftimit të datës 21.07.2023 ankuesi në CV është vlerësuar me gjithsejtë 10.2 pikë, e që nënkupton se ankuesi gjithsejtë ka fituar 59.2 pike dhe nuk ka arritur që të kalojë në fazën e intervistës me gojë.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes njoftimit të datës 27.07.2023 ka shpallur kandidatin fitues në bazë të vlerësimit të Komisionit të Pranimit, ndërsa ankuesi me datën 28.07.2023 ka parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik kundër vlerësimit të jetëshkrimit.

Kryesuesja e Komisionit të Vlerësimit me datë 15.08.2023 ka marr vendimin me numër protokollit 1260 përmes të cilit ankuesit i ka refuzuar ankesën me arsyetim se ankuesi ankesën

lidhur me piket e jetëshkrimit e ka bërë në fund të procedurës e që në këtë raste ka humbur të drejtën për interviste me gojë.

Me qëllim të shqyrtimit të vetmit pretendim të ankuesit ndërlidhur me vlerësimin e jetëshkrimit dhe provave materiale të lëndës respektivisht formularët e vlerësimit të jetëshkrimit, Kolegji i Këshilli, konstaton se anëtarët e Komisionit të Pranimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit kandidatin e kanë vlerësuar, me 10.2 pike, i cili vetëm në fushën e biografisë lidhur me trajnimet nuk ka marr asnjë pike për shkak se nuk e ka dëshmuar me asnjë prove materiale konkretisht Certifikatë për përfundimin e trajnimeve, ndërsa sa i përket fushës së arsimit dhe piket e përvojës se punës ankuesi është vlerësuar (se bashku për të dyja fushat) me 10.2 pikë të përgjithshme, konkretisht sipas dëshmisë së datës 26.10.2023 të ofruar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit në dokumentin në fjale janë fshirë emrat e anëtarëve të komisionit vlerësues mirëpo sipas vlerësimit përfundimtar të jetëshkrimit tek fusha e *arsimit* kandidati është vlerësuar me 3 pike nga njeri anëtarë dhe me nga 4 pike nga dy anëtarët tjerë të komisionit edhe përkundër se ankuesi posedon Diplomën me numër Nr.2219/15 të datës 19.12.2015 të lëshuar nga Kolegji AAB me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet themelore universitare në programin Administrate Publike me date 22.10.2015 dhe ka marr titullin Baçelor në Administrate Publike ashtu siç edhe është kërkuar sipas konkursit me numër të referencës RN00011534 të datës 26.04.2023, ndërsa tek vlerësimi i jetëshkrimit në fushën e përvojës së punës ankuesi është vlerësuar me 4 pike nga njeri anëtarë i Komisionit dhe me 5 pikë nga tjetri edhe përkundër se në baze të dëshmive të ofruara konkretisht Pasqyrës së Llogarisë së Trustit dhe Vendimit të datës 01.04.2019 të Kryetari të Komunës së Skenderajt lidhur me emërimin e ankuesit në pozitën e punës „Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit Komunal “ankuesi ka gjithsejtë katër (4) vite e tetë (8) muaj përvoje pune, ku me shume shumë se dy vite ndërlidhet me pozitën e punës të kërkuar sipas konkursit me numër të referencës RN00011534.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të vlerësimit të jetëshkrimit, ka konstatuar se komisioni i pranimit me rastin e vlerësimit të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2, 3 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 3.Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur më Grupin për të cilët zhvillohet konkurrimi. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet”,* ndërsa në bazë të këtyre dispozitave Kolegji i Këshillit, ka ardhur në përfundimin se anëtarët e Komisionit të Pranimit nuk e kanë vlerësuar ankuesin siç është paraparë në nenin 22 paragrafi 5 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se *5.Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve, andaj Kolegji i Këshillit nuk e ka të qartë se si anëtarët e komisionit të pranimit kanë vlerësuar ankuesin me 10.2 pikë të përgjithshme në jetëshkrimi duke mos e cekur saktësisht kalkulimin e vlerësimit siç është përcaktuar në dispozitat e lartcekura. Tutje Kolegji konstaton se*

vlerësimi i ankuesit në jetëshkrim me 3 dhe 4 pikë nga ana e Komisionit të vlerësimit për një fushë ku ankuesi ka plotësuar kriteret e konkursit është në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Prandaj, sikurse u tha më lartë, mbi bazën e shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si dhe analizimin e dispozitave ligjore të ligjit material dhe rregullores së lartcekur, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Vendimi Nr.Prot: 1260 të datës 15.08.2023 i Komisionit të Pranimit në Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit është i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", ngase Komisioni i Pranimit nuk ka arritur të shqyrtojë meritorisht pretendimin e palës ankuese.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se ka mbetur në fuqi Konkursi me Nr. Reference: RN00011534 të për grupin "Specialist i Përgjithshëm për Inspektim", për pozitën e punës "Inspektor i Punës", sikurse edhe vlerësimi i rezultateve me shkrim, ndërsa Komisioni i Pranimit duhet të zhvilloj procedurën nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit, dhe me rastin e rishqyrtimit të lëndës duhet të respektojë vërejtjet e dhëna juridike në arsyetimin e këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1146/2023

Ilire MEHMETI -SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik;
- Arkivit të KPMSHCK- së.